



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:249754
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05601627

C.nrIV-14-0611

Ankuesi: Z K, M, Malishev,

Kundër

N.N.I.T., Mirusha,, në Klinë”, (në likuidim), përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, lagjja, Lakirsht..rr Dritan Hoxha, nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjyqtaren Ganimete Puka, me datë 22.Prill. 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. PEJ068-0200, dt. 26. Dhjetor. 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datë 03.shkurt.2014, parashtuesi i kërkesës, paraqiti një kërkesë për rishikim të vendimit të AL nr.8197/13, datë 27.12.2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e kontributeve personale në shumë prej 430.00 € nga N.N.I.T “ Mirusha” (në likuidim), si kërkesë e pavlefshme. Ankuesi pohon se kërkesa e tij ka bazë ligjore dhe duhet anuluar vendimi i kontestuar, dhe se kontributet e tij pensionale nga ndërmarrje nuk i janë paguar pra nuk janë refunduar në trustin pensione të Kosovës, siç përcaktohet me ligji, duke kërkuar nga gjykata që ta aprovoj kërkesën në tersi si të bazuar në ligj. Ankuesi kërkesës ia ka bashkëngjitur vendimin e kontestuar, një listë të punëtorëve , njoftimin e AKP, një kopje të listës së pagave Gusht 2023.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me dt 01.06.2021 parashtroj mbrojtësen e saj, duke e kundërshtuar në tersi ankesën si të pabazuar. AKP pohoi se AL, me rastin e vendosjes, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Tutje, pohon se ankuesi nuk ka parashtuar ndonjë argument se cila dispozitë e Ligjit për AKP është aplikuar gabimisht nga ana e AL. AKP gjithashtu pohon se ankesa e ankuesit është pabazuar në kuptim të dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP respektivisht e parashtuar në ankesë. AKP

pohon se vendimi i kontestuar është i ligjshëm, dhe kërkesa e ankuesi është në kundërshtimi me dispozita ligjor të nenin 6 par 2 a dhe 2 b, të Ligjit nr.04/L-101, dhe propozon që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Me datë 08 qershor 2021, ankuesi e ka pranuar mbrojtjen e APK/së, dhe nuk ka dhënë përgjigjen lidhur me këtë.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtresave të palëve.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjënë se nuk është kontestuese se ankuesi ishte punëtor N.N.I.T., Mirusha, në Klinë (Likudim), deri në njoftimin për privatizim. Nuk është kontestues as fakti se ankuesit i janë paguar pagat mujor nga punëdhënësi.

Ndërsa kontestuese janë kontributet pensionale, në shumën prej 430 €, sipas ankuesi të pa paguara.

Gjykata i pranon si prova relevante, Vendimin e kontestuar dt.26.12.2013, listën e punëtoreve, listën e pagave të paguar gusht 2003, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, dhe NSH, rregullisht i ka paguar pagën mujore në shumën prej 230 €(lista e pagave Gusht 2023).

Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh, kontributet pensionale, po ashtu ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë specifikacion se për cilët muaj i kërkon kontributet pensionale të pretenduar, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e kontributeve , por vetëm ka cekur shumën e kërkuar. Ankuesi ka dështuar

që të dorëzoj prova në mbështetje të ankesës së tij. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive-provave, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për kompensimin e kontributeve të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Bazuar në këtë që u tha me lartë, gjykata konsideron se me tu paguar pagat mujore, detyrimisht paguhet edhe kontribute pension ale, vetëm thirrja e ankuesit se nuk i janë paguar nuk do të thotë se detyrimisht i jep të drejt palës në një të drejte të tij ligjor, kjo është e rregulluar me ligj dhe kjo duhet të argumentohet me prova. Këtë pala ankues nuk e ka bërë, dhe në mungesë të provuarit ankesa u refuzuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të ankuesit, mirëpo nuk u lëshuar në arsyeshmërin e tyre, pasi që vlerësoj se nuk do të kishin ndikim në një vendim me ndryshe.

Andaj në bazë të te lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është i liruar nga taksa gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka